



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec
KUVENID I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 01/258 Nr. i faq./Br.str./No.pg 71
Data/Datum/Date 29.10.2024

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), nenit 5 paragrafi 1 pika 1.3, nenit 6, nenit 13 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, të shkresës me rekomandimet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal 020-535-5 të dt. 25.9.2024, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë, **29.10.2024** merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës

1. **Miratohet** propozimi i kryetarit të Komunës, Nr. 02/4595/23, i datës 13.08.2024 dhe merret vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, personave fizikë dhe juridikë deri në 20 (njëzet) vjet, përmes procedurës së shprehjes së interesit.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Gradish, me kulturë: kullosë e klasës V, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë: P -71510033-00772-10, në sipërfaqe prej 2350m² (dy mijë e treqind e pesëdhjetë metra katror), e cila merret nga sipërfaqja e përgjithshme prej 20000 m² (njëzet mijë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është destinimi prodhim tretësor - shërbimi kulturor, argëtues dhe rekreativ.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatgjatë në periudhën prej 20 (njëzet) vjet.
5. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo i çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
6. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga **komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**, sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20, e datës 29.6.2020, për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.

7. Obligohen Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatgjatë, të zhvillojë procedurat e shprehjes së interesit në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
8. Obligohet kryetari i Komunës që, pas përfundimit të procedurave të shprehjes së interesit nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale, të përcaktojë me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe të përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
9. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatgjatë, realizohet përmes shprehjes së interesit.
10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.
11. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 01/241/24, i datës 23.8.2024.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.258/24
Më datë:29.10.2024

